



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Mars 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në vazhden e punëve, detyrave dhe aktiviteteve të shumta në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, gjatë muajit mars të vitit 2018, ka arrit me sukses dhe rezultate të kënaqshme t'i realizon punët dhe detyrat e planifikuara për këtë periudhë kohore, sipas planit të veprimit dhe njëkohësisht punë dhe detyrat tjera të paraqitura.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA;
- Rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Rishikimi funksional i DKA-së;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;

- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionon si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Organizimi i vizitave studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe rritjet arsimore në vendet e zhvilluara;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Analizimi i trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Krijimi i një trupi komunal për bashkërendimin e përpjekjeve për përkrahjen dhe lehtësimin e zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i punëtorëve të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP-së;
- Krijimi i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për mjete të TIK-ut;

- Krijimi i ekipit për identifikimin e nevojave të shkollave për teknologji arsimore;
- P.sh. “School Me” ose platforma online të të nxënës (2018 – pilotim);
- Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtorë, laboratorë/kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Hartimi i programit të investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Shërbimet shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike hartojnë plane pune të integruara sipas nevojave dhe kërkesave të IP-ve;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimmshënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonimë;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjellja dhe realizimi i projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;

- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me freebalance;
- Furnizimi sistematik me naftë i institucioneve edukativo-arsimore.
- Furnizimi me kiflet dhe qumësht të nxënësve të nivelit të arsimit fillor;
- Vlerësimi i lëndës në prokurim “Furnizimi me libra të bibliotekave shkollore”;
- Përgatitja e projektit për prokurim lidhur me furnizimin e kuzhinës qendrore me artikuj ushqimorë;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me material didaktik dhe higjienike;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me rekuizita sportive.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecuritë e zhvillimeve në arsim, dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit mars të vitit 2018, kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar 4 vizita informuese në shkollat fillore dhe të mesme të larta, si: “Dardania”, “Shkëndija”, “Prenk Jakova”, “Abdyl Frashëri”, ndërsa janë realizua edhe pesë vizita të përgjithshme në: SHFMU “Ali Kelmendi”, SHFMU “Dëshmorët e 1921”, SHFMU “Pavarësia”, SHFMU “Azemi e Salihu” dhe në SHML “Hoxhë K. Prishtina”, kurse është realizuar edhe një vizitë speciale në gjimnazin “Eqrem Çabej”;
- Drejtorja e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatoren e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht ka arritur t’i zgjedhë 20 koordinatore të shkollave dhe në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar me Udhëzimin administrativ 24/2016;
- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjen e cilësisë në arsim, gjatë kësaj

periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund të muajit kanë përgatitë raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë, ndërsa shkollat kanë raportuar në DKA për tremujorin e gjysmëvjetorit të dytë, për punët dhe detyrat e realizuara nga aktivet. Po ashtu, aktivet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentorua nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe u ka përgatitë formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;

- Në dymbëdhjetë institucione edukativo-arsimore, janë formuar ekipe për vlerësimin e brendshëm të shkollës, të cilat janë duke operuar brenda institucionit në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim;
- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimit joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët. Ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore është vlerësuar nga ekipi vlerësues një (1) nxënës-fëmijë, ku konstatohet se fëmijët kanë dëmtime të shumëfishta. Pas vlerësimit të gjendjes së tyre, komisioni ka rekomanduar që fëmija-nxënësi të vijon mësimin në Qendrën Burimore;
- Realizimin e praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale, është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm. Kjo është si pasojë e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale, është determinuese në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale.

Shkencëtari i ri

Më 26 mars 2018, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, organizuan garën “Shkencëtari i ri”, në objektin e Gjimnazit Matematik.

Është viti i tretë që organizohet një garë me karakter të tillë në komunën e Prishtinës dhe viti i dytë që realizohet në koordinim edhe me MASHT-in, ndërsa këtë vit garës iu dha një dimension edhe më i gjerë ku, pjesëmarrës ishin edhe nxënësit e komunës së Ferizajt.

Andaj, ky format i garës u organizua vetëm me nxënësit e gjimnazeve të Prishtinës dhe Ferizajt, si: me nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri”, “Ahmet Gashi”, “Alauddin”, “Xhevdet Doda”, “Gjimnazi Matematik” dhe me nxënësit e gjimnazit “Kuvendi i Arbrit”, ku pjesëmarrës ishin gjithsej 39 nxënës të klasave X, XI dhe të XII, të cilët pasi kanë treguar rezultate të larta në garat e zhvilluara në shkollat e tyre, iu nënshtruan testit në nivel komune, në fushën e shkencave natyrore (biologji, kimi dhe fizikë).

Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është identifikimi i talenteve të ri, nxjerrja në pah e shkathtësive dhe kompetencave të tyre në shkencat natyrore dhe, njëkohësisht, mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.

Drejtoria e Arsimit dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në këtë segment kanë hartuar strategji dhe politika stimuluese, në mënyrë që nxënësit që do tregojnë rezultate dhe suksese të larta, do të kenë mbështetjen (shpërblime).

Përmes këtyre aktiviteteve garuese dhe politikave stimuluese për nxënësit e suksesshëm, synohet nxitja e tyre për të garuar në sferën e



dijes dhe për t'i përmirësuar rezultatet e të nxënit.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve sipas standardeve bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësim-nxënie cilësore, me qëllim që cilësia, rezultatet dhe suksesi në shkollat tona të shënojë progres dhe të arrijnë në nivelin e shkollave të përparuara.

NXËNËSIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Klasa	Kodi	Vendi
1	SHML "Sami Frashëri"	Art Berisha	XII-1	01/120	I
2	SHML "Sami Frashëri"	Altina Aliu	XII-8	01/122	II
3	SHML "Ahmet Gashi"	Redon Duraj	X	01/107	II

7 Marsi – Dita e Mësuesit

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit dhe shënimit të 131-vjetorit të hapjes së mësonjëtores së parë shqipe, organizoi program kulturo-artistik për nder të kësaj dite historike të arsimit shqip, ditë e cila hapi dyert e diturisë për kombin shqiptar.

7 Marsi - Dita e Mësuesit, shënohet si një ngjarje me rëndësi politike e kulturore në historinë e arsimit kombëtar shqiptar.

Andaj, në këtë ditë ne të gjithë së bashku kujtojmë dhe nderojmë mësuesit tanë të parë që na mësuam shkronjat shqipe, të cilët na mësuam se si ta duam dhe ta respektojmë atdheun.



Për kontributin e tyre të çmuar në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave dhe mbajtjen në jetë të gjuhës, kulturës dhe arsimit shqiptare, Drejtoria e Arsimit ndau mirënjohje për veteranët e arsimit të moshës 79 deri 84 vjeç, si: Taib Sylejmani, Ramush Ajvazi, Ramadan Paçarada, Igballe Shushka, Muharrem Kozmaqi, Sabedin Sabedinaj, Fakete Binxhiu, Ymrane Shuku dhe Bajrush Ahmeti.



Me mirënjohje u nderuan edhe drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore për punën e dalluar që janë duke e bërë në drejtimin dhe menaxhimin e institucioneve arsimore, si: Sadifete Lumi, drejtoreshë në IP “Ardhmënia”, Isak Bregaj, drejtor në SHFMU “Dardania”, si dhe Bekë Mulaj, drejtor në SHML “Abdyl Frashëri”.

U shpërblyen edhe mësimdhënësit e dalluar të secilit nivel të arsimit parauniversitar, për kontributin në edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj, si: Nashide Hoxha, edukatore në IP “Gëzimi



Ynë”, Ilmie Dumani, mësimdhënëse në shkollën “Dardania”, Shaip Hasani, mësimdhënëse në shkollën “Eqrem Çabej”, Kevser Çarkici.

PISA - 2018

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, me fokus të veçantë organizimin dhe mbarëvajtjen e testit PISA-2018, më 01 mars organizoi takim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe koordinatorët e shkollave të cilët janë të ngarkuar nga shkollat për mbarëvajtjen dhe realizimin e këtij procesit.

Me këtë rast, Drejtori i Arsimit, z. Jonuz Salihaj , theksoi se për të rrjedhë ky proces sipas standardeve



dhe kërkesave të parapara dhe të finalizohet me suksese dhe rezultate sa më të larta për sistemin e arsimit, duhet të ketë mobilizim të përgjithshëm, duke filluar nga Ministria, zyrtarët e DKA-së, drejtorët, e deri te prindërit dhe nxënësit, me qëllim që të shënojmë progres e rezultate sa më të mira në testin PISA 2018. PISA të jetë temë e përditshme e diskutimit në shkollat tuaja, dhe në ditët që kanë mbetur të bashkëpunoni ngushtë me institucionet relevante të emëruar kohë më parë për organizimin e testit PISA 2018. Nxënësit tanë në këtë test nuk e përfaqësojnë vetëm veten e tyre, por e përfaqësojnë vendin me rezultatet që arrijnë”, tha ndër të tjera z. Salihaj.

Testit PISA 2018, në komunën e Prishtinës do t’i nënshtrohen nxënësit e trembëdhjetë shkollave të mesme të larta, si dhe dhjetë shkolla fillore, si në vijim: SHML “Xhevdet Doda”, SHML “Eqrem Çabej”, SHML “Sami Frashëri”, SHML “Ahmet Gashi”, SHML “Gjimnazi i Specializuar Matematikor”, SHML “Alauddin”, SHMEJ “Hoxhë Kadri Prishtina”, SHML “28 Nëntori”, SHML “Gjin Gazulli”, SHML “Abdyl Frashëri”, SHML “Dr. Ali Sokoli”, SHML “Shtjefën Gjeçovi”, SHML “7 Shtatori”, SHFMU “Elena Gjika”, SHFMU “Asim Vokshi”, SHFMU “Emin Duraku”, SHFMU “Ismail Qemali”, SHFMU “Nazim Gafurri”, SHFMU “7



Marsi”, SHFMU “Nënë Tereza”, SHFMU “Shkolla e Gjelbër”, SHFMU “Andon Z. Çajupi” dhe “Mileniumi i Tretë”;

- Drejtori i Arsimit, z. Jonuz Salihaj, së bashku me zyrtarët e arsimit, realizuan vizitë në institucionin edukativo-arsimor “Shkolla e Gjelbër”, ditë kur ky institucion arsimor shënoi Ditë e Efijencës së Energjisë, ku njëkohësisht u realizua edhe hapja e Ekorimorkios Ekologjike - me pajisjet që kanë të bëjnë me vetëdijesimin e popullatës për ripërtëritjen, kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ambientit etj.



Në shënimin e kësaj dite drejtuesit e shkollës, në koordinim me mësimdhënësit, kish bërë gjitha përgatitjet e duhura, në mënyrë që puna e tyre e realizuar të prezantohet në mënyrë profesionale.

Nxënësit bashkë me mësimdhënësit e tyre, në këtë aktivitet prezantuan pajisjet ekologjike dhe rolin e tyre në mbrojtje të ambientit, duke treguar shkathtësi dhe kompetencë të duhur në këtë segment.

Drejtori i Arsimit, z. Jonuz Salihaj, për këtë aktivitet shumë të rëndësishëm dhe vetëdijesues për shoqërinë, i përgëzoi drejtuesit e shkollë, mësimdhënësit dhe në veçanti nxënësit, për shkathtësitë e treguar në demonstrimin e



pajisjeve dhe rolin, efektin e tyre në jetën e përditshme. Kështu që z Salihaj, potencoi se Drejtoria e Arsimit do të jetë gjithëherë në mbështetjen dhe përkrahjen tuaj drejt zhvillimin të mëtejshëm profesional, duke krijuar kushte dhe mundësi më të mira për zbatimin në praktik të njohuritë e arritura;

- Në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Shëndetit Oral, Drejtoria e Arsimit, në koordinim me Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi „KISCOMS“ dhe me Komitetin ndërministror të programit "Shkollat Promovuese të Shëndetit", më 20 mars 2018, ka organizuar ecjen e katërt me radhë, "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur" që ka për qëllim informimin e fëmijëve-nxënësve mbi rëndësinë e shëndetit oral (shëndetit të dhëmbëve dhe të gojës).



Ecja u realizua nën kujdesin e ambasadorëve të projektit "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur", nga sheshi "Zahir Pajaziti" deri te sheshi "Ibrahim Rugova".

Gjatë ecjes, lepuroshi i projektit dhe ambasadorët kanë shpërndarë dhurata për fëmijët (brusha të dhëmbëve).

Ky është viti i katërt shkollor i realizimit të projektit "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur", projekt që monitorohet dhe bazohet në rekomandimet e Komitetit ndërministror të programit "Shkollat Promovuese të Shëndetit" nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), si dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS).

- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhune apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme komfor legjislationit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullores komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes, e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për organizimin e Testit të arritshmërisë -2018 dhe krijimi i qendrave testuese ku do të zhvillohet testi;
- Në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, janë realizuar të gjitha përgatitjet e duhura për testin PISA-2018;

- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit mars;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve, marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Në afatin e paraparë janë furnizuar të gjitha institucione edukativo-arsimore me lëndë djegëse, dru dhe pelet;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kifle dhe qumësht;
- Planifikimi i buxhetit vitit-18- për buxhet BDMS;
- Ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve;
- Janë nënaloquar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënaloquar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë zotuar 220 lëndë për mallra dhe shërbime, si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar 180 lëndë;
- Aprovimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzime nën 100 Euro;
- Mbajtja e evidencës së lëndëve të zotuar me modul blerje, si dhe dorëzimi në prokurim;

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Furnizimi me instrumente muzikore i kabineteve të muzikës;
- Furnizimi me pajisje i kuzhinës qendrore;
- Furnizimi i shkollave me material higjienik;
- Furnizimi i shkollave me material didaktik;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me lëndë djegëse;
- Projekti “Furnizimi i çerdheve me tepih”;
- Projekti “Furnizimi me llaptop, projektorë dhe aparate fotokopjuese”;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtarë;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore.

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, mars 2018

Buxheti i shpenzuar dhe alokuar 03-2018				
Kategoria eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - Obligim	Mbetje -S=
Paga	1,555,509.56	1,555,509.56	-	-
Komunali	38,606.82	35,992.85	2,613.97	-
10-MSH	416,465.00	308,884.91	95,320.09	12,260.00
21-MSH	-	-	-	-
Subvencione	110,520.00	12,400.00	-	98,120.00
Donacione	72,057.73	-	-	72,057.73
FB-21-Kapitale	780,667.00	170,043.29	48,033.65	562,590.06
FB-22-Kapitale	-	-	-	-
Gjithsej:	2,973,826.11	2,082,830.61	145,967.71	745,027.79

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit gjatë muajit janar ka realizuar mbi 160 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara gjatë katër ditëve të javës.

4. Takimet me institucione të tjera.

Për periudhën e muajit mars të vitit 2018, janë realizuar takime me:

- zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;
- përfaqësuesit e ambasadës franceze;
- përfaqësuesit e GIZ-it;
- përfaqësuesit e Avokatit të Popullit;
- përfaqësuesit e organizatë GAP;
- përfaqësuesit e një shoqate nga Bursa-Turqi;
- përfaqësuesit e Zyrës japoneze;
- përfaqësuesit e Asociacionit Nacional të Autizmit në Kosovë;
- përfaqësuesit e Komitetit për persona me aftësi të kufizuara;
- përfaqësuesit e SOS;
- përfaqësuesit e BONEVET;
- auditorë;
- Ministrinë e Financave (takime të rregullta);
- përfaqësuesit e KUR "Prishtina";
- përfaqësuesit e ndërmarrjes "Termokos";
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së.

4.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit mars, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit mars janë pranuar gjithsej 63 lëndë, prej tyre të miratuara janë 28, të refuzuara 14 lëndë, të pezulluara 7 dhe në proces janë 14 lëndë.

6. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara;
- Takim me përfaqësues të Këshillave drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda D

rejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi, përgjegjësi, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës të stafit edukativo-arsimor;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimit të punëve dhe detyrave;
- Zbatimi i Kurrikulës së re.

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës;
- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;

- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA.
- Rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe rritjet arsimore në vendet e zhvilluara;
- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale;
- Organizimi i garës së matematikës;
- Organizimi dhe mbajtja e "Garave të diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Organizimi i garës "Shkencëtari i ri";
- Organizimi i garës "Fizikanët e rinj";
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisë Profesionale);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Krijimi i një trupi komunal për bashkërendimin e përpjekjeve për përkrahjen dhe lehtësimin e zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Monitorim i zbatimit të kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP;

- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimeve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimeve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisje dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikohen nevojat e shkollës për mjete të TIK-ut;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkollë;
- Ekipi në fjalë hulumton trendet e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtorë, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Hartimi i listave për nevojat e secilës shkolle për punëtorë, kabinete /laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Trajnimi i mësimeve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Hartimi i programit të investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë, në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Shërbimet shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike, hartojnë plane pune të integruara sipas nevojave dhe kërkesave të IP-ve;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimeve që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;

- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë.

10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme